

BASHKIA TIRANE

FTESË PËR OFERTË

Bashkia e Tiranës, bazuar në VKM-në nr.1181, datë 23.07.2008 për “Përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia” dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë” dhe VKM-në nr.27, datë 19.01.2007 për “Miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion vendor të ndërtimit të parkimit nëntokësor, në parkun “Rinia”, Tiranë.

Kërkoheq që projekti të realizohet tek parku “Rinia”, Tiranë.

Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në Drejtorinë e Prokurimeve, pranë Bashkisë së Tiranës. Tel/fax + 355 4 2256 799; e-mail prokurimet@tirana.gov.al; website www.tirana.gov.al

Një kopje e plotë e dokumenteve standarde të konkurrimit, mund të blihet nga kandidatët e interesuar me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Autoritetit Kontraktues në zyrën e cituar më sipër dhe me pagesën e një tarife të pakthyeshme prej 10.000 (dhjetëmijë) Lekë. Pagesa për blerjen e dokumenteve të konkurrimit do të bëhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë e Tiranës. Mandat pagesa do të paraqitet pranë Sektorit të Informimit Qytetar në Bashkinë e Tiranës nga ku operatorët ekonomikë të interesuar do të pajisen me dokumentet e konkurrimit.

Ofertuesit duhet të paraqesin vetëm një ofertë.

Ofertuesit duhet të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.

Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinalë ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të dërgohen tek Bashkia e Tiranës, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë. Sigurimi i ofertës, që është në shumën prej 2 % të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese

Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 20.04.2009, ora 11.00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen dhe do t'i kthehen të pa hapura ofertuesit. Ofertat do të hapen në Bashkinë e Tiranës, datë 20.04.2009, ora 11.00. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.